



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 21 Maj 2021

Nr: 88

VENDIMI

“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE ANKIMORE NR. 34, NR. 35 TË PARTISË LËVIZJA
SOCIALISTE PËR INTEGRIM DHE NR. 42 TË PARTISË DEMOKRATIKE TË
SHQIPËRISË”

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 21.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Kryesues
Elvin LAKO	-	Anëtar
Iirjjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

Ankues 1 : Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;

Ankues 2 : Partia Demokratike e Shqipërisë

Palë e interesuar : Partia Socialiste e Shqipërisë

OBJEKTI:

- 1- Kundërshtimi i Vendimit Nr. 339, datë 04.05.2021 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”;
- 2- Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Berat;

- 3- Shpalljen e pavlefshme të procesit të votimit në disa qendra votimi të Qarkut Berat;
- 4- Përsëritjen e Zgjedhjeve në qarkun e Beratit;
- 5- Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-të 63, 64, 65, 66, 67, 68 dhe QV-të e listuara dhe miratim i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Qarku Berat duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124, 132, 133, 136, 138, 144, 160, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe vendimi nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 25.04.2021, në 12 Zonat Zgjedhore në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse.

Zona Zgjedhore Qarku Berat ka 6 (gjashtë) zona të administrimit zgjedhor, përkatësisht ZAZ nr 63, ZAZ nr. 64, ZAZ nr. 65, ZAZ nr. 66, ZAZ nr. 67 dhe ZAZ nr. 68.

Në datë 04.05.2021, me vendimin nr. 339, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Berat në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
2. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Partia Lëvizja Socialiste për Integrim e cila pretendon ndër të tjera se janë konstatuar:
 - Ekzistenca e fletëve të votimit pa vula, për disa qendra votimi;
 - Tentativa për votim të dyfishtë nga i njëjti zgjedhës, fakt i konstatuar nga printimet PEI;
 - Mungesa e operatorit të pajisjes PEI në QV 3446;
 - Mospërputhje në numërim e zgjedhësve, fletëve të votimit dhe gjinisë bazuar në raportin e pajisjes PEI dhe procesverbalin për QV 3431;

- Mungesa e raporteve të pajisjes PEI, raportin e hapjes dhe mbylljes si dhe mungesa e shënimeve në librin e protokollit për QV 3445;
- Mospërputhje e numërit të votuesve më numërin e fletëve të votimit për QV 3318;
- Mosvlerësimi i drejtë i fletëve të votimit të kontestuara për QV 3356;
- Ekzistenca e fletëve të pavlefshme në zarfat 06 dhe 08 për subjektin zgjedhor Partia Socialiste në QV 3265, QV3267, QV 3281, QV 3285, QV 3305/1, QV 3305/2, QV 3316, QV 3311;
- Miratimi i Tabelës Përmbledhëse të rezultateve të ZAZ nr. 66 Qarku Berat pavarësisht konstatimit të parregullsive nga 3 anëtarë të kësaj ZAZ-je;
- Në disa ZAZ mungojnë procesverbalet e hapjes dhe mbylljes dhe raportet PEI;
- Nga verifikimi i pamjeve filmike të vëna në dispozicion nga KQZ, rezultojnë se numrit të votave të vlefshme, apo të përfshira si vota të vlefshme për një tjetër subjekt zgjedhor është relativisht i lartë. Nga leximi i këtyre anomalive apo parregullsive në kualifikimin jo të rregullt të votës, rezultojnë se subjektit LSI duhet t'i shtohen të paktën 80 (tetëdhjetë) vota sipas konstatimit të pamjeve filmike;
- Materiali zgjedhor i nxjerr nga pamjet filmike në shumë raste krijon dyshime të arsyeshme se vlerësimi i votës nuk është bërë në mënyrë të drejtë nga grupet e numërimit.

Përfundimisht, subjekti ankues LSI kërkon:

- Ndryshimi i Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 339, datë 4.05.2021 Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021;
- Shpalljen e pavlefshme të procesit të votimit në qendrat e votimit të Qarkut Berat vijuese: QV 3446, QV. 3431, QV 3445, QV 3318, QV 3275, QV 3270, QV 3287, QV 3307, QV 3472, QV 3473, QV 3482, QV 3325, QV. 3456. QV. 3440, QV. 3330, QV. 3220, QV.3433, QV 3328, QV 3429/1, QV. 35181, QV 3518, QV. 3513, QV. 3501, QV. 3416;
- Përsëritjen e Zgjedhjeve në qarkun e Beratit;
- Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-të 63, 64, 65, 66, 67, 68 dhe QV-të e listuara dhe miratim i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Qarku Berat duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.

3. Kundër vendimit nr. 345/2021 të KSHZ-së ka paraqitur ankim gjithashtu koalicioni Partia Demokratike-Lëvizja për Ndryshim (PD-AN). Ky subjekt ankues pretendon:

- Gjatë periudhës mars-prill 2021, PD ka depozituar 50 kallëzime penale në Prokurorinë e Posaçme SPAK dhe 130 kallëzime në prokuroritë e rretheve, të cilat kanë të bëjnë me vepra penale të tilla si “Shpërdorim detyre”, “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, “Përdorim i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” etj;
- Në qarkun e Beratit janë konstatuar raste të blerjes së votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera nga disa figura të larta të Partisë Socialiste, duke shpërndarë dhurata për kategori njerëzish me qëllime elektorale, duke caktuar dhënien e një shpërblimi fundviti për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, duke ndryshuar strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësit e tjerë me arsim të lartë etj;
- Janë përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve;
- Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Beratit shqyrtonte kërkesën e kësaj të fundit për akordimin e ndihmës financiare për familjet banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri si dhe nga tërmeti i vitit 2019 nga buxheti i bashkisë “Programi Emergjencat Civile”. Me vendimin nr. 21, date 29.03.2021, Këshilli Bashkiak vendosi të miratojë vlerën e ndihmës së menjëhershme financiare prej 1.080.002 Lek për 7 familje. Ndihma financiare do të përballohej nga fondi i emergjencës së Bashkisë për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkohshme të jetesës, pasi fondi i akorduar nuk ishte i planifikuar në Buxhetin e vitit 2021;
- Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Beratit miratoi ndryshimet në Vendimin e vitit 2019 në lidhje me sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Beratit. Ndryshimi që miratoi Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Beratit në thelb shtynte afatin e pagimit të taksave dhe tarifave vendore. Në vendimin që u ndryshua, taksat dhe tarifat vendore paguheshin në dy këste, kësti i parë paguhej brenda datës 20 Prill (para zgjedhjeve), ndërsa kësti i radhës më 20 Qershor. Me Vendimin nr. 22, datë 29.03.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr. 60, datë 18.12.2019 të Këshillit Bashkiak Berat “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Beratit”, pagesa e kështit të parë u caktua deri më datën 30 maj (pas zgjedhjeve), ndërsa pagimi i kështit të dytë u caktua deri më datën 30 gusht 2021;
- Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra;
- Nga viti 2017 e në vijim, Qeveria ka nxjerrë 28 vendime duke shtuar numrin e punësimeve në strukturat e qeverisjes qendrore me 16645 pozicione të reja, për përfitim politik, duke devijuar vullnetin;

- Sipas Ministrisë së Financave, për periudhën janar-prill 2021 janë paguar 20 milionë euro më shumë për paga krahasuar me në njëjtën periudhë të vitit 2020;
- Me qëllim ndikimi në shtresat vulnerabël, bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave, qeveria ka paguar për ndihmën ekonomike për familjet në nevojë 313,763,706 lekë më shumë për periudhën janar-prill 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020;
- Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021; këto të dhëna janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucione të tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata;
- Në 17 prill 2021, Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi elektoral në qytetin e Durrësit, falenderoi patronazhistët për punën e bërë. Fakti që vetë Kryeministri e pranoi këtë fenomen dhe e normalizoi atë përmes falenderimeve, tregon se databaza të njëjta me ato të publikuara kanë ekzistuar në të gjithë Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe Beratit. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR;
- Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantët që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht mbi 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuese;
- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në, u evidentuan si problematikë edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR. Në opinionin e tyre të përbashkët, Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës dhe ODIHR-i shprehën keqardhje që procedurat e miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor kishin qenë jashtëzakonisht të nxituara dhe që nuk ishin paraprirë nga një proces i duhur konsultimi.
- Numri i votave të pavlefshme ishte 83.026, ose 5 % e numrit total të votuesve dhe ky fakt është ndikuar nga përmbajtja e fletës së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve;
- Ligji diskriminon kandidatët gjatë procesit zgjedhor, duke u lejuar vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidati tjetër, që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta;

Përfundimisht, PD kërkon pranimin e ankimit për kundërshtimin e Vendimit nr. 339, datë 04.05.2021 “Për Miratimin e Tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore qarku Berat për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

4. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore të depozituar nga subjekti zgjedhor PD-AN dhe provat bashkëlidhur me të;
- Kërkesën ankimore të depozituar nga subjekti zgjedhor LSI dhe provat bashkëlidhur me të;
- Raportin e kryqëzimit të të dhënave nga pajisjet PEI për qarkun e Beratit;
- Dëshmia e Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, zj. Lealba Pelinku, e dhënë para KAS në seancën e datës 19.05.2021;
- Rezultatet e këqyrjes së kutive të materialeve zgjedhore.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

Analiza ligjore:

1. Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij formojnë kuadrin e rregullave që menaxhojnë zgjedhjet. Ato përcaktojnë si të drejtat e palëve pjesëmarrëse në proces, ashtu edhe mjetet ligjore për mbrojtjen e tyre nga shkelja. Format e shkeljes së të drejtave ligjore të palëve janë të pafundme. Një pjesë prej tyre njihen dhe adresohen nga praktika zgjedhore. Pjesa tjetër identifikohen rishtazi. Mjetet ligjore nga ana tjetër janë vetëm ato që përcakton kuadri ligjor. Për këtë arsye, identifikimi i mjetit ligjor të përshtatshëm që i përgjigjet një shkeljeje të caktuar ka rëndësi vendimtare për mbrojtjen me sukses të të drejtave të cënuara.
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në duart e subjekteve ankuese, i cili mundëson anulimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve:
 - a) *shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;*
 - b) *fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim;*
ose

c) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë.

3. Shkaqet sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës pararendëse kanë lidhje vetëm me procesin e votimit, kurse shkaqet sipas shkronjës “a” kanë lidhje me procesin në përgjithësi (përfshirë votimin dhe rezultatin e zgjedhjeve). Mosfillimi i votimit ose pezullimi i tij nuk ka nevojë të ketë ardhur si rezultat i shkeljeve ligjore, që të shkaktojë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një qendër votimi. Mjafton ekzistenca e faktit juridik të mosfillimit apo pezullimit për më shumë se 5 (pesë) orë. Po kështu, pavlefshmëria sipas shkronjës “b” nuk kërkon shkak tjetër përveç ngjarjes së fatkeqësisë natyrore dhe pengimit të zgjedhësve për të marrë pjesë në votim. Fatkeqësitë natyrore përfshijnë të gjitha format e motit të ashpër dhe me tipare kërcënuese për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, pronën, infrastrukturën bazë dhe sigurinë kombëtare, si stuhitë, përmytjet, zjarret, orteqet e borës dhe të dheut, tërmetet etj. Pandemia e Covid-19 është emergjencë shëndetësore dhe nuk mund të përfshihet dhe as të barazohet me fatkeqësitë natyrore.
4. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. **Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur.** Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu, shitblerja e votës që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh dhe që këtë herë u cilësua si “problem i përhapur”, nuk u vëzhgua prej tyre në masë kritike.
5. Masa kritike ndryshon nga një vend në tjetrin, nga një demokraci në tjetrën, sepse masa kritike varet tërësisht nga shkalla e zhvillimit demokratik. Në çdo demokraci qëllimi është zhvillimi i zgjedhjeve dhe legjitimitimi i pushtetit nga populli. Masa kritike është instrumenti që mbron zgjedhjet dhe demokracinë nga deligjitimitimi.

6. Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre mjete ligjore është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor. Nevoja për provueshmëri imponon edhe nevojën për të provuar lidhjen shkakësore midis shkeljes dhe pasojës së rëndë, pengimit/largimit të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrimit të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, ose tjetërsimit në masë të votës së hedhur.
7. Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë edhe një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkakun themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur, por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore. Kriteri ligjor për matjen e ndikimit përcaktohet nga neni 161 i Kodit dhe është gjithmonë numerik. Sipas pikës 2 të këtij neni “*ndikim në ndarjen e mandateve për zgjedhjet në Kuvend (do të kemi) kur numri i zgjedhësve, që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme, është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse, mbi bazën e përllogaritjes...*” sipas formulës d’Hond të nenit 162.
8. Kodi Zgjedhor ka përpunuar një numër filtrash e garancish të cilat mbrojnë aspekte të caktuara të procesit nga cënimi, prishja apo manipulimi. Filtrat dhe garancitë si rregull janë ndërvepruese dhe komplementare. Për mbrojtjen nga votimi i shumëfishtë p.sh. ndërveprojnë lista e zgjedhësve, me emrin e zgjedhësit vetëm në një listë qendre votimi, procedura e rreptë e kontrollit të identitetit të votuesit, përdorimi i bojës matrikulluese, lënia e gjurmës së gishtit në

pajisjen PEI, kontrolli a posteriori i të dhënave të grumbulluara nga pajisjet PEI për të gjithë vendin dhe, së fundi, mbikëqyrja reciproke e anëtarëve të komisioneve dhe monitorimi i këtyre të fundit nga vëzhguesit e subjekteve. Dy apo shumëfishimi i filtrave dhe garancive i shërben qëllimit që integriteti i procesit të mbrohet edhe në rastet kur ndonjëri prej tyre nuk funksionon, dështon apo administrohet keq. Kjo është arsyeja pse procesi nuk atakohet dot menjëherë për pavlefshmëri, nëse gjatë kontrollit apo verifikimit të dokumentacionit konstatohen pasaktësi, parregullsi, gabime materiale, gabime njerëzore apo shkelje procedurale. Procesi mund të atakohet për pavlefshmëri kur provohet se integriteti ka rënë (rasti i kutive të parregullta), ose ka rënë në masën që ka prishur rezultatin (nenin 136, pika 1, shkronja “a”).

9. Argumentet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Këto kërkesa që burojnë nga dispozita e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor janë konfirmuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese dhe zgjedhore shqiptare, e cila është e njohur dhe e referuar si bazë arsyetimi juridik edhe nga ankuesi në kërkesën e tij ankimore. Vendimi nr.75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese, i cili mund të shërbejë si bazë për të identifikuar metodologjinë për saktësimin dhe konkretizimin e termit “shkelje që çenojnë rëndë procesin zgjedhor”, kërkon që arsyetimi juridik i KAS-it të kalojë nëpërmjet *“përcaktimit të kritereve, koncepteve bazë si dhe parimeve mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues”*. Shkeljet që çenojnë rëndë procesin zgjedhor duhet të jenë shkelje të tilla që e bëjnë të pavlerë rezultatin e tyre, sikurse *“aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën...(duhet të jenë të tilla që) e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese”* për zyrtarin e lartë.
10. Kolegji Zgjedhor, i cili është marrë posaçërisht me interpretimin e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, sipas tekstit që është sot në fuqi, në vendimin e tij nr.45, datë 18.11.2013, ka konfirmuar karakterin përjashtimor të rasteve të pavlefshmërisë dhe përsëritjes së zgjedhjeve. Sipas Kolegjit Zgjedhor *“përsëritja e zgjedhjeve nuk mund të kryhet për çdo shkelje të evidentuar, qoftë kjo edhe lidhur me parimet e zgjedhjeve, **përveçse kur provohet se shkeljet janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin final**”*. Kolegji Zgjedhor çmon se nuk mjafton që të provosh se janë kryer shkelje që kanë çenuar procesin zgjedhor për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por duhet të provosh se *“këto shkelje të jenë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit”*. Gjithashtu, Kolegji ka saktësuar se pretendimi se shkelja *“përbën fenomen masiv, ndaj edhe mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve”* duhet të provohet në gjykim, përndryshe ngelet në kuadrin e një hipoteze dhe nuk mund të merret për bazë nga gjykata.

11. Kolegji Zgjedhor në vendimin e tij të vitit 2013 i ka kujtuar ankuesit të atëhershëm barrën e provës, e cila është detyrim thelbësor i palës në procedurën tonë administrative dhe civile. Pika 1 e nenit 82 të KPrA saktëson: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij.”* Këtë detyrim e vendos edhe Kodi Zgjedhor nëpërmjet shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 136 kur u kërkon palëve *“të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”*. Kodi Zgjedhor kërkon në mënyrë të shprehur që pretendimet të jenë të mbështetura në prova, sepse Kodi kërkon që t’i presë rrugën e suksesit kërkimeve të pathemelta ose me ves. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se në raportin midis provës dhe pretendimit, prova vjen e para. Provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.
12. Palët gëzojnë të drejta të plota procedurale për të aksesuar provat jo vetëm sipas Kodit Zgjedhor, por edhe të ligjit për të drejtën e informimit apo të ligjit për avokatinë. Kjo është arsyeja që Kodi vënien në lëvizje të KQZ-së për *“marrjen e provave për të vërtetuar faktet”* (shkronja “c” e pikës 1 të nenit 136) e kushtëzon me pamundësinë e palës (për shkaqe bindëse) për t’i siguruar vetë dhe paraprakisht ato.
13. Jo çdo kërkim i palëve në procedurën ankimore në KAS mund të mbështetet në të drejtat (e palës) dhe privilegjet (e anëtarëve të veçantë) që akordon neni 136 i Kodit Zgjedhor. Që kërkimi të merret në konsideratë apo të respektohet duhet që ai të plotësojë kushtet ligjore të të qenit “provë”. Neni 136 përcakton se *“llojet e provave përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile”* (shkronja “b” e pikës 1). Kodi i Procedurës civile përcakton se provat janë thëniet e dëshmitarëve (Kreu VII), shkresat (Kreu VIII), pohimet e palëve (Kreu IX), këqyrja e personave, sendeve, këqyrja në vend dhe eksperimentimi (Kreu X). Shkresat, të cilat meritojnë vëmendje nga këndvështrimi i çështjes objekt shqyrtimi paraqiten si shkresa (nenet 246-252), akte zyrtare (nenet 253-257), shkresa të thjeshta dhe shkresa private (nenet 258-263).
14. Pika 1 e nenit 86 të KPrA përcakton se *“kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, organi publik, kryesisht apo me kërkesën e justifikuar të palës, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës)”*. Sigurimi i provës është një veprim procedural i ndryshëm nga marrja e saj. Sigurimi i provës kushtëzohet nga emergjenca, nga rëndësia e provës dhe nga nevoja për të mbrojtur provën nga zhdukja ose pamundësia permanente për akses. Kodi Zgjedhor e njeh sigurimin e provës si veprim procedural në nenin 167/2 të tij. Ky nen lejon këqyrjen e mëpasshme të fletëve të votimit dhe të materialit zgjedhor

për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimin e numërimit të votave. Këqyrja lejohet të bëhet vetëm pasi të jetë shpallur rezultati përfundimtar, të jenë përmbyllur procedurat ankimore dhe zgjedhjet të kenë përfunduar. Në kuadër të procesit ankimor lejohet të preken fletët e votimit ose materiali zgjedhor jo për të kërkuar prova, për të bërë analiza, apo hulumtime, por vetëm për të bërë sigurimin e provës.

15. Kuadri ligjor i zgjedhjeve, me Kodin Zgjedhor, aktet nënligjore dhe aktet e tjera zbatuese në fuqi, është premisa e procesit zgjedhor. “Kodi Zgjedhor shërben si një bazë e përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike”, konstatoi misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it në deklaratën e tij për gjetjet dhe konkluzionet paraprake për zgjedhjet e 25 prillit. Në asnjë rrethanë kuadri ligjor nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Aktet nënligjore dhe aktet zbatuese kontestohen veçmas, sipas rastit, me mjetet e ankimit administrativ dhe gjyqësor. Kur ato janë në fuqi, ato respektohen. E drejta e kryetarëve të subjekteve zgjedhore për të kandiduar deri në katër zona zgjedhore është e drejtë ligjore e tyre. Kompozimi i fletës së votimit është bërë më bazë të ligjit, aktit nënligjor të rregullatorit dhe vendimit të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Ai është i rregullt dhe i ligjshëm. Procedura e ruajtjes së gjurmës së gishtit nga PEI është në përputhje të plotë me aktet që rregullojnë atë. Të gjitha këto janë pjesë e kuadrit ligjor për zgjedhjet. Respektimi i këtyre akteve i bën zgjedhjet të rregullta dhe të ligjshme, kurrsesi të pavlefshme.

16. Hetimi i veprave penale zgjedhore është ekskluzivitet i organeve të prokurorisë. Ai nuk pezullon shqyrtimin administrativ të ankimeve zgjedhore, por KAS-i nuk mund të paragjykojë, as të ndikojë rezultatet e hetimit penal përgjatë shqyrtimit të vet administrativ. Kallëzimet penale nuk provojnë ekzistencën e një ngjarje kriminale. Ato janë vetëm mjet ligjor për të vënë në lëvizje një hetim. Ekzistencën e një ngjarje kriminale e provon ligjërisht vetëm organi i hetimit dhe e konfirmon ligjërisht vetëm organi gjyqësor. KAS-i nuk mund as të provojë, as të konfirmojë ekzistencën e një ngjarje kriminale. KAS-i mund të marrë në shqyrtim ngjarje dhe fakte juridike, të cilat janë gjithashtu pjesë e lëndës së një hetimi penal, por mund t’i shqyrtojë ato vetëm për aq sa i nevojitet procedurës së shqyrtimit administrativ dhe vetëm nga këndvështrimi i legjislacionit zgjedhor.

Analiza e provave dhe fakteve:

1. Nga pohimet e avokatit të subjektit ankues PD (shih procesverbalin e shqyrtimit të kërkesës ankimore për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Berat) rezulton se provat e paraqitura prej këtij subjekti ankues dhe të pranuarat për shqyrtim nga KAS-i nuk faktojnë sa

raste shitblerje vote, sa raste lejesh legalizimi, sa raste punësimi, sa raste mohimi të së drejtës për votim për emigrantët, sa raste votimi të shumëfishtë ka pasur në qarkun e Beratit. Po kështu, ato nuk faktojnë se sa secili prej këtyre fenomeneve, apo edhe i formave të tjera të përdorimit të burimeve shtetërore, i dhënies së ndihmave apo i ushtrimit të presionit mbi zgjedhësit kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës. Sipas avokatit të subjektit kërkues këto të dhëna mund të reduktoheshin vetëm nga informacionet e institucioneve shtetërore. Pavarësisht nga ky fakt, subjekti ankues nuk kishte bërë asnjë përpjekje për sigurimin e tyre, por kërkoi që KQZ-ja t'i merrte ato. Subjekti ankues nuk ishte në gjendje të identifikonte nëse ekzistonin dokumente pranë këtyre institucioneve që të përmbanin informacionin e kërkuar. Ai pohoi në seancë se nuk kishte disponuar mbi të dhëna nga informacionet e kërkuar në momentin e hartimit të kërkesës ankimore, por besonte se, nëse merreshin si prova, ato do të konfirmonin pretendimet e ankuesit.

2. Në rrethin e provave të pranuar për shqyrtim janë një grup dokumentesh fotokopje, përfshirë fotot bashkëlidhur një pjese të kallëzimeve penale. KAS-i i pranoi këto prova për shqyrtim për shkak se ato ose janë marrë nga burime publike, ose nuk u kontestuan nga asnjëra nga palët e përfshira në proces.
3. Subjekti ankues ka depozituar si prova në mbështetje të pretendimeve të veta 1 (një) kallëzim penal. Kallëzimi penal i depozituar si provë nuk provon në asnjë rast ekzistencën apo vërtetësinë e fakteve apo ngjarjeve të përshkruara në të. Ai provojnë vetëm faktin se PD për zonën zgjedhore Qarku Berat ka depozituar së paku një kallëzim penal.
4. Kodi Zgjedhor përcakton në pikën 4 të nenit 91: “4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1076, datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, të ndryshuar” ka dalë brenda periudhës së ndalimit dhe sjell rritje pagash për kategori të caktuara punonjësish publikë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1044, datë 18.12.2020 “Për një shtesë

në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar” është miratuar përpara fillimit të periudhës së ndalimit, prandaj nuk përbën shkelje, sikurse miratimi i vendimit nr. 1102, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021” nuk përbën shkelje, sepse ai është vendim procedurash dhe kriteresh lidhur me një fond që është dhënë me ligjin për buxhetin e vitit 2021. Shkelja e kryer në favor të subjektit zgjedhor PS me nxjerrjen e VKM nr. 1076, datë 24.12.2020 formon kundërvajtje administrative sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Nga pohimet e përfaqësuesve administratës së KQZ-së rezultojnë se PD nuk ka bërë ankim në KQZ për këtë shkelje.

Në këtë kategori pretendimi bën pjesë edhe vendimi nr. 21, datë 29.03.2021 i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Berat sëbashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri si dhe nga tërmeti i vitit 2019 nga buxheti i Bashkisë vitit 2020 “Programi Emergjencat Civile”. KAS konstaton se ky vendim përbën kundërvajtje administrative, sepse ka dalë brenda periudhës së ndalimit dhe parashikon dhënie të lehtësirave financiare për 7 përfitues. Megjithatë, nga informacionet e marra nga administrata e KQZ-së, rezultojnë se subjekti ankues nuk ka vënë në lëvizje KSHZ-në sipas procedurës së parashikuar në nenin 172 të Kodit Zgjedhor.

Lidhur me pretendimin e shprehur në pikën 15 të kërkesës ankimore të subjektit ankues PD-AN, KAS konstaton se vendimi nr. 22, datë 29.03.2021, “Për një ndryshim në vendimin nr. 60, datë 18.12.2019 të Këshillit Bashkiak Berat “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Beratit”, ka lidhje me afate dhe procedura. Ky vendim nuk sjell përfitime, nuk ul detyrimet, nuk fal taksat, por vetëm shtyn afatin, për një shkak ligjor të besueshëm dhe të justifikueshëm. Për këtë arsye, nuk formon shkelje në kuptim të pikës 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

5. Një grup provash të depozituara nga subjekti ankues ilustronë debatin mediatik rreth të ashtuquajturit “skandali i patronazhistëve”, i cili ka lidhje me një bazë të dhënash prej rreth 900 mijë zgjedhësish, ku ishin fiksuar, ndër të tjera, dhe preferencat e aluduara politike të tyre. Nga tërësia e të dhënave të bazës janë me interes për zgjedhjet të dhënat për preferencat politike. Këto të dhëna janë dukshëm produkt i punës së “patronazhistëve”, mbështetur në “eksplorimin” e tregut politik nga strukturat partiake. Kjo metodë eksplorimi politik bën pjesë në taktikat tradicionale të partive politike, ndonëse metodat ndryshojnë nga njëra parti në tjetrën. Pjesa tjetër e të dhënave janë të dhëna personale, që janë siguruar në mënyrë të paqartë, përveç listës me emra zgjedhësish e cila është publike dhe u ofrohet partive politike në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor (pika 2 e nenit 60). Përdorimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale

rregullohet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Rrethanat e lidhura me skandalin e patronazhistëve provojnë shkallën e ulët të respektimit të rregullave të vendosura nga ky ligj në Shqipëri. Provat e paraqitura në këtë kontekst provojnë sensibilitetin ndaj ngjarjes, por jo ndikimin e saj tek votuesit. Subjekti ankues nuk solli prova se publikimi mund të kishte intimiduar zgjedhësit dhe t'i kishte mbajtur ata larg nga procesi i votimit. Pjesëmarrja në këto zgjedhje në zonën zgjedhore Qarku Berat ishte 80933 (44,20%), nga 85374 (47,25%) që ka qenë në vitin 2017. Në ditën e votimit misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it vuri re në disa qarqe “grupe të rinjsh që grumbulloheshin jashtë qendrave të votimit dhe dukej se kontrollonin zonën dhe mbanin shënim se kush votonte”. Edhe kjo formë patronazhi është pjesë e taktikave elektorale të partive të mëdha, pjesë e metodave që kompletojnë bazat e të dhënave të partive politike. Por edhe për këtë nuk u servirën prova që të tregonin intimidimin e zgjedhësve apo detyrimin e tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar.

6. Subjekti ankues LSI ka ngritur një grup pretendimesh në kërkesat e tyre ankimore të cilat referojnë në një listë parregullësish, pasaktësish dhe gabimesh materiale dhe njerëzore në administrimin e procesit të votimit ose numërimit dhe tabulimit të rezultateve. KAS-i i mori në shqyrtim këto pretendime, dhe konkludon se këto pasaktësi dhe gabime njerëzore e materiale, nuk formojnë shkak për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Për këtë arsye, provat që lidhen me këto pretendime, nuk mund të quhen prova pavlefshmërie.
7. Kodi Zgjedhor ka parashikuar mundësinë për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit që të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin. Komisionit Rregullator i është lënë kompetenca e posaçme që të vendosë “zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin” (shkronja “ç” e pikës 2 të nenit 20). Në zgjedhjet e 25 prillit 2021 Komisioni Rregullator nuk e shfrytëzoi këtë kompetencë, duke mos e ligjëruar mundësinë e kësaj kategorie zgjedhësish të votonin në distancë. Në këto zgjedhje mund t’a shfrytëzonin këtë mundësi, nëse do bëhej e aplikueshme, vetëm 3613 zgjedhës nga 4572 shtetas të regjistruar me banim jashtë shtetit (të dhënat janë marrë nga KQZ-ja). Për shkak të mosaplikimit të votimit nga jashtë vendit, e drejta e tyre e votimit do të realizohej në këto zgjedhje vetëm nëpërmjet paraqitjes në qendrën e tyre të votimit. Ky modalitet votimi është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Pamundësia e votimit në distancë në këto zgjedhje për shtetasit shqiptarë me banim jashtë shtetit nuk formon shkelje. Atje ku nuk ka shkelje nuk ka pavlefshmëri.
8. Subjektet ankuese ngritën pretendime kundrejt urdhrin nr.219, datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e

Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia” si një “vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës”. Urdhri i sipërcituar është motivuar me nevojën për të dominuar përhapjen e epidemisë Covid-19, në kushtet e “kontakteve më intensive në popullatë deri në përfundim të festës dhe veprimtarive fetare të lidhura me pashkët ortodokse”. Vetizolimi i personave që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë është një masë që është marrë në mënyrë të përsëritur që nga koha e nisjes së pandemisë dhe ka qenë e lidhur me statistikat e sëmundshmërisë dhe pritshmëritë nga ngjarje të caktuara. Mbyllja, izolimi apo vetizolimi kanë qenë masa dominuese edhe në rastet e festave të tjera zyrtare, publike ose fetare. Në kohën që u mor kjo masë Republika e Greqisë ka pasur në fuqi izolimin 14 ditor dhe numrin e kufizuar të hyrjeve për personat që hynin në territorin grek nga Shqipëria. Më vonë kjo masë u shndërrua në izolim 7 ditor. Shqipëria e mbajti në këmbë këtë masë deri më datën 3 maj 2021, d.m.th. deri pas festës. Urdhri nr.219, datë 19.04.2021 është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.

9. Subjekti ankues PD-AN ka referuar se në ditën e zgjedhjeve kanë qenë 23.000 persona të infektuar me Covid-19, sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë. Statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës për zonën e Beratit. Për zgjedhësit e kësaj kategorie nuk ka qenë e mundur të votonin në kushtet e izolimit. Deklarata e Misionit vëzhgues të OSBE-ODIHR-it e ka quajtur këtë “mohim de facto i të drejtës për të votuar” (faqe 7). Kodi Zgjedhor nuk parashikon mundësinë e votimit në distancë për zgjedhësit me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, sikurse nuk autorizon KQZ-në që të përpunojë rregulla dhe të marrë masa për kryerjen e një votimi të tillë. Ky është kuadri ligjor për zgjedhjet. Kushtetueshmëria e tij nuk është sfiduar në rrugë ligjore. Edhe kushtetueshmëria e rregullave të izolimit për shkak të pandemisë Covid-19 nuk është sfiduar në rrugë ligjore. Kjo është arsyeja që Misioni vëzhgues e quan rezultatin mohim de facto, por nuk e quan shkelje. Atje ku nuk ka shkelje nuk ka pavlefshmëri.
10. Një pretendim i veçantë ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Në zonën zgjedhore Qarku Berat numri i këtyre votave është 5292 ose 6.54% e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë, sepse mungon baza krahasuese. Pas ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor, votuesve iu dha mundësia të ushtronin të drejtën e tyre, duke hedhur dy vota, një për subjektet dhe një tjetër për kandidatët.

Statistika nuk mund të krahasohet me votimet e kryera në Shqipëri, kur zgjedhësit kanë hedhur vetëm një votë. Në vlerësimin e subjektit ankues pavlefshmëria e lartë lidhet me kompozimin e fletës së votimit, gjë që përforcohet edhe nga deklarata e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve e datës 28.04.2021. Subjekti ankues nuk paraqiti asnjë fakt që të provonte lidhjen shkakësore midis vendimit të Kolegjit Zgjedhor për përmbajtjen e fletës së votimit dhe numrit të lartë të fletëve të pavlefshme. Deklarata e Komisionerit nuk e nxjerr këtë lidhje. Nga ana tjetër, ka një grup shkaqesh, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë analizës faktike rreth kësaj çështjeje si p.sh. fakti se në këto zgjedhje u votua me dy vota dhe probabiliteti i gabimit dyfishohej, fakti se fushata edukuese nuk pati efektin e dëshiruar ose nuk e davariti dot konfuzionin, fakti se kandidatët nuk harmonizuan dot mënyrën e re të votimit me taktikat elektorale, apo fakti se pavlefshmëria mund të ishte mënyrë votimi me dashje nuk mund të eliminohen vetëm për shkak se nuk përputhen me linjën e arsytimit të ankuesit. Misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it identifikon si shkak të mundshëm vonesën në nisjen e fushatës informuese-edukuese. Pavlefshmëria e votës është pjesë e rregullave të votimit dhe numërimit të votave, nuk është mohim i së drejtës për të votuar (nuk ka mohim të së drejtës kur e drejta është ushtruar), nuk është shkelje e Kodit Zgjedhor, për pasojë nuk formon shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve.

11. Subjekti ankues PD ka përfshirë në ankim një numër provash që bëjnë fjalë për individë të aluduar me rekorde të tmerrshme kriminale, të cilët janë të lidhur me interesa biznesi me shumicën qeverisëse dhe që janë përfshirë “si eksponentë që kontribuonin në këtë fushatë edhe për shkak të përfitimeve që kanë marrë nga PS”. Faktet e referuara në provat e depozituara dhe në shtjellimin e kërkesës ankimore nuk krijojnë lidhje faktike dhe logjike me shkelje të Kodit Zgjedhor dhe nuk provojnë kërkesën për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve.
12. Subjekti ankues PD u tërhoq nga pretendimi i tij i shprehur në pikat 49-51 të kërkesës ankimore dhe e zëvendësoi atë me pretendimet që rezultuan nga administrimi i rezultateve të kryqëzimit të të dhënave nga pajisjet PEI të përdorura për identifikimin e votuesve. Subjektet ankuese në tërësi pretenduan se materiali shpjegues me statistikat e kontrollit të kryqëzuar të të dhënave PEI dhe dëshmia e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve provojnë se ka patur parregullsi në administrimin e pajisjeve, të cilat kanë lidhje me regjistrimin e një gjurme daktiloskopike për më shumë se një identitet zgjedhësi, sikurse ka pasur raste të izoluara të personave me identitet dhe gjurmë daktiloskopike të njëjtë në dy qendra votimi të ndryshme. Në vlerësimin e përfaqësuesit të subjektit ankues PD ky fakt provon se ekziston mundësia që një person i vetëm të ketë votuar në emër të shumë zgjedhësve dhe kjo e bën votimin në këto raste të pavlefshëm. Nga shqyrtimi i materialit të servitur nga KQZ-ja rezulton se ai jep informacion për fazën e parë të hetimit administrativ që neni 167/2 i KZ kërkon të kryhet “pasi të jetë shpallur rezultati përfundimtar, të

jenë përmbyllur procedurat ankimore dhe zgjedhjet të kenë përfunduar” me qëllimin “për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave”. Rezultatet e servirura në material formojnë indicie për hetimin administrativ të KQZ-së, por nuk formojnë dot prova për të mbështetur pretendimin e subjekteve ankuese“ për raste të shumta të votimit të dyfishtë”. Materiali i servirur konstaton se për zonën zgjedhore ka një listë prej 57 rastesh të identifikuar me gjurmë daktiloskopike të dyshuara të njëjta nga pajisjet, por jo të përputhshme. Nëse gjurmët do ishin të përputhshme, atëherë pajisja do t’i kish deklaruar të përputhshme ato. Vetëm në dy raste ky dyshim përfaqëson gjurmën daktiloskopike me identitetin e njëjte në dy qendra votimit të ndryshme. Mbi bazën e informacionit të përftuar nga materiali i servirur mund të ngrihen vetëm hipoteza për sjelljen e zgjedhësve të evidentuar por nuk mund të krijohet bindja për shkelje të provuara, aq më tepër për votim të dyfishtë. Nga palët në proces u argumentua se materiali i servirur provon se administrimi i procesit nga operatorët ka qenë i parregullt. KAS-i çmon se ky pretendim nuk ka lidhje me pretendimin për votim të shumëfishtë për të cilin ishte kërkuar marrja e provës. Ky material dhe stadi aktual i hetimit administrativ të KQZ-së nuk e provon pretendimin për votim të shumëfishtë.

13. Subjekti ankues PD e ka mbështetur kërkesën e vet për pavlefshmëri edhe në deklaratën e Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për gjetjet dhe konkluzionet paraprake, të datës 26.04.2021. Dokumenti përmban gjetje dhe të dhëna për shpërndarjen e votës dhe për përdorimin e burimeve shtetërore, të cilat janë referuar në kërkesën ankimore. Në vlerësimin e këtij dokumenti KAS-i duhet të ndajë referencat me burim interlokutorët nga referencat me burim vëzhguesit e misionit. Në vlerësimin e tij të përgjithshëm misioni vëzhgues ka konstatuar se edhe në këto zgjedhje “mbetën problem praktikë gjerësisht të përhapura të blerjes së votës” (faqe 2), sikurse ka konsideruar të besueshme “raportimet sipas të cilave koordinatorët e partive të mëdha u ishin afruar për t’u blerë votat një numri domethënës votuesish nga komunitetet rome dhe egjiptiane (faqe 16). Deklarata evidenton faktin se “ministrat vijuan fushatën përgjatë veprimtarive zyrtare dhe me këtë publicitet i dhanë përparësi domethënëse partisë qeverisëse”, sikurse thekson se ishin shqetësime dhënia e incentivave dhe pretendimet për presion mbi nëpunësit publikë (faqe 2). Dokumenti nuk përmban të dhëna specifike në lidhje me Qarkun Berat në këto aspekte. Gjetjet dhe konkluzionet paraprake të deklaratës janë të besueshme dhe të pranueshme. Sipas gjetjeve dhe konkluzioneve të kësaj deklarate të ODIHR, ka përhapje të fenomenit, blerja e votave është e pranishme si metodë së paku tek partitë e mëdha. Gjithsesi, përmasat e këtyre fenomeneve nuk formojnë, në gjykimin e misionit vëzhgues, shkak për pavlefshmëri, përndryshe deklarata nuk do t’i konsideronte zgjedhjet si zgjedhje ku “votuesit

mund të zgjidhnin midis kandidatësh, të cilët mund të bënin lirshëm fushatë, me një kuadër ligjor që respekton liritë themelore” dhe ku “zgjedhjet ishin në përgjithësi të mirëorganizuara”(faqe 1).

14. Subjekti ankues PD kërkoi nga KAS-i që të merrte në cilësinë e provës 19 informacione specifike nga institucione të ndryshme që veprojnë në territor. KAS-i, pasi shqyrtoi kërkesën vendosi me shumicë votash rrëzimin e saj për shkak se:

- subjekti ankues nuk ka bërë përpjekje për të siguruar paraprakisht provat, sikurse kërkon shkronja “c” e pikës 1 të nenit 136 të Kodit Zgjedhor. Ky është një kusht ligjor që duhet të demonstrohet se është plotësuar në momentin që paraqitet kërkesa për marrjen e provës, përndryshe dispozita nuk do kërkonte që kërkuesi të paraqiste njëkohësisht me kërkesën edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i provave;
- Informacionet e kërkuara nuk gëzojnë cilësinë e provës, sipas Kodit të Procedurës Civile dhe për këtë shkak nuk mund të kërkohen si të tilla. Kodi garanton të drejtën për të kërkuar prova, jo sende që nuk janë të tilla. Llojet e provave janë të përcaktuara. Asnjëri prej 19 kërkimeve nuk bën pjesë në asnjërin nga llojet e provave që përcakton KPrC;
- Kërkimi nga institucionet shtetërore i informacioneve që nuk ekzistojnë, por që duhet të prodhohen prej tyre del jashtë tagrave që i njeh KAS-it pika 1 dhe pika 2 e nenit 137 të Kodit Zgjedhor. Kërkesat e subjektit ankues janë në fakt kërkesa për të vënë në punë institucionet, me qëllim që ato të hulumtojnë, studiojnë, analizojnë, apo prodhojnë statistikë lidhur me fenomenet e pretenduara si shkelje nga ana e subjektit ankues.

Subjekti ankues PD, i pyetur nga KAS-i, nuk referoi tek asnjë dokument zyrtar i këtyre institucioneve ku mund të gjendeshin informacionet e kërkuara, pavarësisht se është në detyrimin e tij të identifikojë provën dhe të tregojë se ku ndodhet ajo (neni 126, pika 1 shkronja “dh”), sikurse pranoi se nuk kishte dijeni nëse informacionet e kërkuara ekzistonin apo jo.

Shumica e anëtarëve të KAS-it çmojnë se ushtrimi në këto kushte i privilegjit nga dy anëtarë për të kërkuar marrjen e provave në mbështetje të pikës 3 të nenit 136 të KZ përbën tejkalim të autorizimit ligjor dhe dëmton administrimin e rregullt dhe në afatet e përcaktuara ligjore të shqyrtimit administrativ.

Kërkesa e dy anëtarëve të KAS-it drejtuar KQZ-së për marrjen e të dhënave të kryqëzuara ndërmjet pajisjeve të identifikimit elektronik PEI për të gjitha zonat e ankimura gjithsesi ka vlerë, sepse ilustron më së miri pse kërkimet mësipërme të subjektit ankues përtej kushteve dhe kufizimeve të neneve 136 dhe 137 mund të dëmtonin shqyrtimin administrativ. Për shkak se prova e kërkuar nga dy anëtarët nuk ekzistonte, KAS-i u detyrua të pezullonte shqyrtimin e

çështjes për shumicën e kërkesave ankimore për 1-7 ditë, deri sa KQZ-ja të bënte kryqëzimin e të dhënave dhe të nxirrte një rezultat të administrueshëm nga palët dhe KAS-i.

Analiza e pretendimeve:

1. Arsyetimi i subjektit ankues PD konsiston në argumentimin e veprimit kumulativ të një serie shkeljesh dhe parregullsish të supozuara ose të provuara të cilat kanë degraduar zgjedhjet në atë masë, sa që rezultati i tyre është jolegjitim dhe zgjedhjet duhet të shpallen të pavlefshme në të gjithë zonën zgjedhore. Sipas pohimit të përfaqësuesve të subjektit ankues pretendimi do mund të provohej kryesisht nga rezultatet e kërkimit të tij drejtuar institucioneve, i cili u rrëzua nga KAS-i. Subjekti ankues nuk ka pasur në dispozicion, nuk ka pasur dijeni dhe nuk mund të parashikonte përfundimet që mund të dilnin nga prova të cilat nuk ekzistojnë në momentin e ngritjes së pretendimit. Pretendimi i ngritur kryesisht mbi hipoteza është një pretendim kryesisht i pa mbështetur në prova. Edhe prova e kërkuar me nismën e dy anëtarëve për një informacion që nuk disponohej nga KQZ-ja dhe që u vu në dispozicion pa përfunduar hetimin administrativ, nuk pati vlerën e provës, por vetëm të indicieve. Raporti informativ u shfrytëzuar nga subjekti ankues PD vetëm për të ngritur hipoteza “manipulimi”, ndërkohë që provonte në shumicën e tij vetëm parregullsi dhe gabime njerëzore, të cilat nuk çënojnë rregullshmërinë e zgjedhjeve dhe rezultatin e tyre.
2. Për KAS-in rezulton i mbështetur në prova pretendimi se:
 - në rastin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. nr. 1076, datë 24.12.2020, miratimi dhe nxjerrja e aktit është kryer në periudhën e ndalimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 91 të KZ. Neni 172 i KZ e trajton këtë rast si kundërvajtje administrative, por trajtimi i tij nuk mund të bëhet kryesisht nga KAS-i, ndërkohë që rezulton e provuar se subjekti ankues nuk e ka vënë në lëvizje KQZ-në për këtë çështje;
3. Për KAS-in rezulton i pambështetur në ligj pretendimi se përbëjnë shkelje:
 - nxjerrja e urdhrit nr.219, datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" dhe mohimi, për këtë shkak, i të drejtës së emigrantëve për të votuar;
 - moskrijimi i kushteve për të votuar për personat e sëmurë me Covid-19;
 - miratimi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pa pëlqimin e subjektit ankues, i ligjit nr. 115/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së

Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe i ligjit nr. 118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”;

- miratimi i vendimit nr. 21, datë 29.03.2021 i Këshillit Bashkiak Berat;
- vendimi nr. 22, datë 29.03.2021 i Këshillit Bashkiak Berat;
- numri i lartë i votave të pavlefshme për zonën zgjedhore;
- e drejta e kryetarëve të subjekteve zgjedhore për të kandiduar në më shumë se një zonë zgjedhore;
- kryerja e punëve apo investimeve publike gjatë fushatës zgjedhore;
- dhënia e lejeve të legalizimit gjatë fushatës zgjedhore.

4. Për KAS-in rezulton i pambështetur në prova pretendimi se:

- të ketë pasur blerje të votës, dhënie të ndihmave, dhënie ose premtim për dhënien e përfitime nga skemat shtetërore, presion ose kanosje mbi zgjedhësit në rastet e kallëzuar penalisht për këtë shkak;
- lejet e legalizimit që identifikohen në kallëzimet penale të jenë dhënë nga autoritetet kompetente në këmbim të premtimit për të votuar Partinë Socialiste;
- punësimet e identifikuar të jenë kryer kundrejt premtimit për të votuar Partinë Socialiste, të jenë kryer në periudhën e fushatës zgjedhore, në mungesën e shkaqeve të përligjura apo të emergjencave;
- publikimi i të dhënave personale të zgjedhësve (skandali i patronazhistëve) të ketë ndikuar në intimidimin e zgjedhësve për të marrë pjesë në votim, apo në detyrimin e tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar;
- numri i lartë i votave të pavlefshme të ketë lidhje me mënyrën e kompozimit të fletës së votimit;
- “persona me rekorde të tmerrshme kriminale” të kenë pasur lidhje shkakësore me ndonjë nga shkeljet e pretenduara në kërkesën ankimore;
- të ketë pasur raste të provuara jashtë çdo lloj dyshimi të arsyeshëm të votimit të shumëfishtë.

5. Për KAS-in rezulton e provuar se:

- publikimi i të dhënave personale të zgjedhësve (skandali i patronazhistëve) nuk ka ndikuar në uljen e pjesëmarrjes së zgjedhësve në votim;
- lëshimi i lejeve të legalizimit nuk ka ndikuar në rezultatin e votimit.

Përfundimi:

1. Shqyrtimi administrativ evidentoi raste shkeljesh të detyrimeve ligjore, të cilat formojnë kundërvajtje administrative. Shkeljet e evidentuara nuk provohet të kenë pasur ndikim në pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim, në ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të së drejtës së tyre apo në tjetërsimin e vullnetit. Ato nuk formojnë “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor” dhe as “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore”, për pasojë nuk mund të shërbejnë si shkak për të shpallur zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi.
2. Çdo ngjarje, fakt apo situatë e zhvilluar në zbatim apo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nuk formon shkelje dhe nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.
3. Çdo shkelje e pretenduar dhe që nuk mund të provohet se ka ndodhur ose se ka pasur ndikim mbi zgjedhjet në formën e pengimit të zgjedhësve për të marrë pjesë në votim, detyrimin të tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar apo në formën e tjetërsimit të votës nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.
4. Në mbledhjen e datës 19.05.2021, me shumicë votash, KAS mori vendim të ndërmjetëm për këqyrjen e provës nëpërmjet hapjes së kutive dhe rinumërimit të votave në kutitë e kërkuara nga subjekti ankues LSI, bazuar në provën e sjellë prej tyre të tabelës përmbledhëse të rezultateve nisur nga pamjet filmike të pretenduara për 114 kuti.

Rezultati i rinumërimit u përmbledh në tabelën e rezultateve për çdo Qendër Votimit.

Në përfundim të këtij procesi, subjekti ankues LSI kërkoi:

- 1- tabela e rezultateve e miratuar nga KAS të mos përfshihet në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për qarkun e Beratit;
- 2- të mos ndryshojë tabela përmbledhëse e rezultateve e miratuar me vendimin nr. 339/2021 të KSHZ-së;
- 3- të shpallen të pavlefshme zgjedhjet në 3 QV, përkatësisht QV 3445, QV 3431 dhe QV 3318.

Në vijim të kësaj kërkesë të re, KAS konstatoi se kërkesa për shpalljen e pavlefshme të QV-ve të mësipërme është shqyrtuar tashmë nga ky Komision dhe për to është marrë vendim i ndërmjetëm në të njëjtën çështje. Këto QV nuk kanë qenë të përfshira në rinumërim, e për pasojë nuk ka shkaqe ligjore lidhur me numërimin, për të cilat mund të kërkohet pavlefshmëria. KAS çmon se tabelat e reja përmbledhëse duhet të jenë pjesë e rezultatit përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, mbështetur në nenin shkronjën “d” të pikës ,1 të nenit 30, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, KAS

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 35, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.
2. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 42, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD - AN);
3. Ndryshimin e vendimit nr. 339, të datës 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve të zonës zgjedhore qarku Berat për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, sipas rezultatit të dalë nga rinumërimi i 114 kutive të votimit për votat e subjekteve zgjedhore dhe rinumërimin të 2 kutive të votimit për votat e kandidatëve, të kërkuara nga subjekti LSI në kërkesën ankimore nr. 34, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Rrëzimin e kërkesës për shpalljen e pavlefshmërisë së rezultatit të zgjedhjeve për Qendrat e Votimit nr. 3445, nr. 3431 dhe nr. 3318, të qarkut Berat për shkak se konsiderohet “gjë e gjykuar” në kërkesën ankimore nr. 35 të subjektit ankimues LSI, për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qarkun Berat.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, sëbashku me vendimin përfundimtar brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Elvis	ÇEFA	-	Kryesues (Kundër pjesërisht)
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilijan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar (Kundër Pjesërisht)



TABELA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR PAS RINUMËRIMIT TË 114 KUTIVE, QARKU BERAT



Subjekti	ZAZ 63	ZAZ 64	ZAZ 65	ZAZ 66	ZAZ 67	ZAZ 68	TOTALI	%
Partia Socialdemokrate	80	51	103	82	27	34	377	0,50%
Partia Balli Kombëtar	34	38	37	43	5	27	184	0,24%
Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare	35	18	30	24	5	3	115	0,15%
Partia Bindja Demokratike	85	30	50	35	11	13	224	0,30%
Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët	29	35	29	12	4	11	120	0,16%
Lëvizja Socialiste për Integrim	885	1605	1706	1174	864	2175	8409	11,12%
Partia Nisma Thurje	46	85	99	47	12	30	319	0,42%
Partia Lëvizja e Re	35	71	93	43	15	4	261	0,35%
Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"	4983	5354	7205	3667	1044	776	23029	30,44%
Partia Aleanca Demokracia e Re	25	6	60	23	2	2	118	0,16%
Partia Lëvizja Për Ndryshim	25	27	51	32	7	8	150	0,20%
Partia Socialiste e Shqipërisë	7216	9414	11281	7019	3866	3541	42337	55,97%
Totali i votave të vlefshme	13478	16734	20744	12201	5862	6624	75643	100%

**TABELAT E REZULTATEVE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTETË, QARKU BERAT
PAS RINUMËRIMIT TË 2 KUTIVE**

Partia Socialdemokrate

		ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		80	52	102	81	27	34		377
Kandidatët për deputetë									
1	Rajmonda Dalipaj	18	6	36	21	10	9		100
2	Ertigel Bardho	5	4	5	5	0	0		19
3	Muharrem Senka	3	0	6	3	2	0		14
4	Anisa Hoxha	3	2	5	4	0	2		16
5	Altin Allidri	4	3	12	2	2	3		26
6	Enea Isufi	2	0	4	2	2	0		10
7	Sejdi Babaliu	0	0	0	1	0	3		4
8	Anila Bitri	1	2	1	0	0	0		4
9	Kristel Frashëri	3	3	4	1	1	2		14
Gjithsej vota të vlefshme		39	20	73	39	17	19		207

Partia Balli Kombetar

		ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		32	38	38	42	5	27		184
Kandidatët për deputetë									
1	Adriatik Alimadhi	4	5	10	7	1	7		34
2	Ledjona Kërçova	4	6	6	14	0	2		32
3	Petrit Luli	2	2	0	1	0	0		5
4	Edmond Kapllani	0	0	0	0	0	0		0
5	Arife Molla	4	1	2	0	1	0		8
6	Mustafa Dusho	1	0	0	0	1	2		4
7	Metohor Brahimaj	1	0	1	1	0	0		3
8	Esmeralda Dusho	0	0	0	0	0	0		0
9	Eridjon Alimadhi	0	0	2	0	0	1		3
Gjithsej vota të vlefshme		16	14	21	23	3	12		89

Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare

			ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin			35	17	30	18	5	4		115
Kandidatët për deputetë										
1	Endri	Qahalliu	6	3	8	8	1	0		26
2	Artan	Hatellari	1	0	2	0	1	0		4
3	Katerina	Ago	1	0	3	1	0	1		6
4	Veli	Hunda	1	0	0	5	0	0		6
5	Veiz	Goxhaj	1	0	0	0	0	0		1
6	Arlinda	Bezhani	0	0	0	1	1	1		3
7	Dhionis	Musollari	0	1	0	0	1	0		2
8	Xhevdet	Rama	1	0	1	0	1	0		3
9	Elizabeta	Gjishti	3	0	0	0	0	0		3
Gjithsej vota të vlefshme			14	4	14	15	5	2		54

Partia Bindja Demokratike

			ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin			84	30	51	35	11	13		224
Kandidatët për deputetë										
1	Plarent	Aleksi	8	2	19	4	1	1		35
2	Elvis	Kondakçiu	11	0	3	0	1	0		15
3	Antoneta	Rustemi	8	0	0	0	0	0		8
4	Elisabeta	Pepa	10	4	4	5	2	1		26
5	Denisa	Mbrakulli	0	0	0	0	1	1		2
6	Veli	Gjishti	2	0	0	3	0	0		5
7	Erison	Karamani	9	3	3	3	0	0		18
8	Xhuvana	Çela	1	0	1	0	0	0		2
9	Foni	Haxhimihali	1	1	2	0	0	1		5
Gjithsej vota të vlefshme			50	10	32	15	5	4		116

Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët

ZAZ		63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		29	36	28	12	4	11	120
Kandidatët për deputetë								
1	Nertila Shalari	4	3	3	2	0	5	17
2	Vasil Mama	2	0	1	1	0	0	4
3	Dorjan Demaj	0	0	5	0	0	0	5
4	Elsa Voka	0	0	2	0	0	0	2
5	Kita Nova	3	2	7	2	3	2	19
6	Andon Qako	1	0	1	0	0	0	2
7	Fatime Pepa	0	0	1	0	0	0	1
8	Aleks Bezhani	0	0	0	0	0	0	0
9	Marije Çipi	1	2	1	0	0	2	6
Gjithsej vota të vlefshme		11	7	21	5	3	9	56

Levizja Socialiste per Integrim

ZAZ		63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		884	1603	1704	1165	864	2174	8409
Kandidatët për deputetë								
1	Ardit Çela	153	318	500	206	243	102	1522
2	Blenard Nonaj	131	161	237	92	73	1,789	2483
3	Esmeralda Qirko	98	37	289	53	10	2	489
4	Petrit Sinaj	90	69	438	338	67	24	1026
5	Ilir Oboni	65	426	28	27	17	6	569
6	Aurela Kalivaçi	31	99	27	49	33	15	254
7	Lifter Maliqi	41	304	35	250	5	2	637
8	Esmeralda Hoxha	8	3	14	16	322	7	370
9	Shkëlqim Tafa	122	8	13	6	3	4	156
Gjithsej vota të vlefshme		739	1.425	1.581	1.037	773	1.951	7.506

Partia Nisma Thurje

		ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		46	84	99	46	12	30		319
Kandidatët për deputetë									
1	Marjana Jaho	17	17	43	11	2	2		92
2	Altin Naçi	3	2	10	2	0	3		20
3	Anxhela Tabaku	1	2	3	1	3	0		10
4	Hajdër Koxha	1	0	3	1	0	0		5
5	Euglena Liçe	1	1	3	0	0	0		5
6	Eglantina Tafa	1	1	1	0	1	0		4
7	Anxhela Delibashi	1	3	6	5	0	0		15
8	Vesart Guri	0	0	0	0	1	10		11
9	Dea Çela	0	1	0	1	0	0		2
Gjithsej vota të vlefshme		25	27	69	21	7	15		164

Partia Levizja e Re

		ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		35	70	95	47	15	4		261
Kandidatët për deputetë									
1	Majlind Mejdani	12	5	43	7	3	2		72
2	Tomorr Laze	1	8	5	1	1	0		16
3	Anxhela Toska	0	7	0	2	0	0		9
4	Aurel Baku	3	6	8	0	0	0		17
5	Entela Bejdo	1	3	5	0	0	0		9
6	Vangjel Buda	1	0	4	0	0	1		6
7	Vilma Gjika	0	1	0	0	0	0		1
8	Xhulio Xhindi	0	2	5	0	2	0		9
9	Era Vavla	1	0	7	0	0	0		8
Gjithsej vota të vlefshme		19	32	77	10	6	3		147

Partia Demokratike - "Aleanca për Ndryshim"

		ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin			4992	5358	7214	3653	1045	776	23029
Kandidatët për deputetë									
1	Tomor Alizoti		846	869	2136	771	273	222	5.117
2	Kasëm Mahmutaj		372	440	2117	1091	234	69	4.323
3	Aferdita (Pushi)Gjini		79	121	638	241	45	93	1.217
4	Bujar Hoxhaj		2329	286	327	340	154	135	3.571
5	Pellumb Nako		44	53	113	29	25	32	296
6	Alketa Mukavelati		59	91	289	143	20	7	609
7	Ardit Benja		50	1974	150	77	16	5	2.272
8	Denis Saatçiu		41	40	212	15	17	7	332
9	Ermira Arizi(Bullari)		171	340	201	114	28	13	867
Gjithsej vota të vlefshme			3991	4214	6183	2821	812	583	18.604

Partia Aleanca Demokracia e Re

		ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin			16	6	58	23	2	2	118
Kandidatët për deputetë									
1	Rolenc Mato		3	1	28	6	0	0	38
2	Amina Shehu		0	2	5	1	0	0	8
3	Drilona Xhindi		0	0	3	1	0	0	4
4	Santiljano Kovaçi		3	1	6	0	0	0	10
5	Ana Turhani		0	0	2	0	0	0	2
6	Milika Kurici		0	0	0	0	0	0	0
7	Olsi Zylyftari		0	0	0	0	0	0	0
8	Fjorida Demko		0	0	0	0	0	0	0
9	Indri Hoxha		0	0	2	0	0	2	4
Gjithsej vota të vlefshme			6	4	46	8	0	2	66

Partia Lëvizja Për Ndryshim

		ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		25	28	50	31	7	8		150
Kandidatët për deputetë									
1	Miranda Haxhia	4	5	9	7	0	2		27
2	Edmond Sinjari	2	3	19	1	0	0		25
3	Alion Kaloçi	0	0	0	3	0	2		5
4	Mikeliano Harka	5	0	1	0	1	0		7
5	Enea Saliasi	3	0	3	1	2	2		11
6	Ogerta Paci	0	1	1	0	0	0		2
7	Kristi Skenderaj	0	1	1	0	0	0		2
8	Xheni Hoxha	0	0	0	0	1	0		1
9	Retilda Musa	0	0	2	0	0	0		2
Gjithsej vota të vlefshme		14	10	36	12	4	6		82

Partia Socialiste e Shqiperise

		ZAZ	63	64	65	66	67	68	Shuma
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		7236	9399	11312	6990	3871	3547		42337
Kandidatët për deputetë									
1	Hatixhe Konomi	376	410	2742	2001	206	63		5798
2	Bardhyl Kollçaku	715	4613	459	432	124	53		6396
3	Fadil Nasufi	656	227	1832	1485	182	33		4415
4	Nasip Naço	772	725	1051	472	233	1430		4.683
5	Blendi Klosi	2772	1864	3312	1204	1833	1414		12399
6	Sara Satka	120	106	181	72	335	37		851
7	Jurgen Pushi	28	40	152	23	19	9		271
8	Klajdi Qama	44	23	114	46	431	15		673
9	Rabushe Hoxha	356	57	58	28	22	31		552
Gjithsej vota të vlefshme		5.839	8.065	99.01	5.763	3.385	3.085		36.038

MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 34 dhe 35 të subjektit zgjedhor partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe nr. 42 të subjektit zgjedhor koalicioni Partia Demokratike e Shqipërisë – Aleanca për Ndryshim me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 339, datë 04.05.2021 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Berat për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021; Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Berat; Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Berat në periudhën më të afërt zgjedhore; Rinumërimin dhe rivlerësimin e votave për ZAZ-te 63, 64, 65, 66,67 dhe 68, të paraqitura në KQZ në datat 09.05.2021 dhe 10.05.2021, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e ankimeve në lidhje me kërkesat ankimore nr. 35 të subjektit zgjedhor partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe nr. 42 të subjektit zgjedhor koalicioni Partia Demokratike e Shqipërisë – Aleanca për Ndryshim, kërkesa këto me objekt pavlefshmërinë e zgjedhjeve, ndaj ju paraqesim në vijim argumentet tona për këtë qëndrim:

1. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS), nuk ka arritur në një konkluzion të drejtë për vendimmarrjen e ndërmjetme në lidhje pavlefshmërinë e kërkuar nga dy subjektet ankimuese (për sa pretenduar në të dy kërkesat ankimore nr. 35 dhe nr. 42 objekt i këtij shqyrtimi administrativ), për sa kohë që shumica e anëtarëve të tij vendosi të mos pranonte kërkesën e përfaqësuesit të subjektit ankimes Partia Demokratike e Shqipërisë për kërkimin e informacioneve dhe provave shtesë.
2. Qëndrimi i shumicës së anëtarëve të KAS, që të refuzojë *en block* marrjen e të gjitha informacioneve apo provave të kërkuara nga një prej ankimesve, është në fakt në shpërfillje të parashikimeve të nenit 137 të Kodit Zgjedhor, por edhe të nenit 223 të Kodit të Procedurës Civile për provën. Ky qëndrim bie ndesh me parimet e hetimit administrativ e më konkretisht me nenit 77 të K.Pr.Administrative që parashikon se “1. *Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes. 3. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t’i kërkojë palës vetëm elementet e nevojshme për identifikimin e tyre*” apo muatits mutandis (meqenëse KAS është *quasi* gjykatë për shqyrtimin administrativ të kërkesave ankimore në

fushën e zgjedhjeve) me nenin 14 të K.Pr.Civile që parashikon se “Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin”.

3. Për ne anëtarët në pakicë, shqyrtimi administrativ duhet të kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme për një hetim të plotë:
 - Tregohet shkak i arsyeshëm për kryerjen e shkeljeve që kanë ndikuar (ose mund të kenë) procesin zgjedhor në tërësi ku përfshihet dhe periudha përpara datës së zgjedhjeve dhe/ose rezultatet;
 - Ekzistojnë arsye më bazë për të treguar fakte që mund të verifikohen ose vërtetohen përmes përpjekjeve të mëtjeshme hetimore, veçanërisht mbledhjes së provave;
 - Një kërkesë ankimore duket se paraqet një pretendim *prima facie* të bazuar;
 - Rrethanat faktike dhe mjedisi aktual justifikojnë veprime të mëtjeshme; dhe
 - Veprimet e mëtjeshme hetimore administrative i shkojnë përshtat interesit publik.
4. Ideja e drejtësisë zgjedhore duhet të respektohet gjatë gjithë kohës kur përcaktohet se cila palë ka barrën për të provuar një fakt ose pretendim specifik dhe si paraqiten provat gjatë shqyrtimit administrativ. Për shkak të natyrës komplekse dhe politike të çështjeve të lidhura me proceset zgjedhore, procesi me të cilin barra e provës u ndahet palëve duhet të përcaktohet qartë paraprakisht kur paraqiten çështjet dhe shpërndarja e barrës midis palëve duhet të jetë e drejtë, pa ngarkuar një palë të mbajë të gjithë peshën e provës kur një çështje paraqitet për shqyrtim administrativ.
5. Si rregull kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen me provën që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor” dhe çështja e provueshmërisë së këtyre shkeljeve ligjore të pretenduara nga ankimuesit është e një rëndësie themelore, në mënyrë që KAS të dalë me një vendim të drejtë lidhur me objektin e ankimit. Por, përpara se të arrihet në konkluzionin që shkeljet e evidentuara nuk formojnë “shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”, apo që këto shkelje nuk mund të provohet se kanë ndodhur ose që kanë pasur ndikim mbi zgjedhësit për tjetërsimin e votës, fillimisht duhet të ndalemi në analizën e faktit nëse ankimuesit kishin mundësi objektive, në kushtet aktuale, që të siguronin provat në mënyrën e duhur. Edhe kjo analizë gjithashtu nuk mund të bëhet pa vlerësuar së pari gravitetin e fenomeneve të pretenduara nga ankuesi.

Ankimuesit në kërkesat ankimore të tyre, veçmas ose së bashku, kanë evidentuar katër drejtime kryesore apo mekanizma të përdorura për deformimin e vullnetit të zgjedhësve. Konkretisht:

- a. Blerja e votës dhe përdorimi i personave me precedentë kriminalë;
- b. Blerja e votës nëpërmjet përdorimit në mënyrë të paligjshme të burimeve shtetërore;
- c. Intimidimi i votuesve nëpërmjet përdorimit të paligjshëm të të dhënave personale;
- d. Mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve dhe të sëmurëve me Covid-19.

Për të ilustruar dhe provuar të gjitha pretendimet e cituara më sipër, ankimuesit kanë paraqitur disa prova, ndërkohë që gjithashtu në përputhje me nenet 136, 137 dhe 138 të Kodit Zgjedhor kanë paraqitur kërkesë për marrjen nga KAS të 19 (nëntëmbëdhjetë) informacioneve dhe provave shtesë.

6. Ankuesit kanë depozituar në KAS dokumentacionin të cilin ata e kanë pasur të mundshëm për ta aksesuar apo siguruar brenda afatit 5 ditor për depozitimin e kërkesave ankimore. Janë depozituar ndër të tjera edhe artikuj gazetalesh që pasqyrojnë veprime apo veprimtari (të pretenduara si të kundërligjshme) të ditura botërisht në momente të caktuara si edhe rastet e konstatuara nga vetë subjektet zgjedhore të tentativave të blerjes së votës apo të ndikimit të paligjshëm tek votuesit. Duhet pasur në konsideratë fakti se provimi me dokumentacion zyrtar i ngjarjeve të tilla nga ana e ankimuesve, është një proces pothuajse i pamundur për sa kohë subjektet politike nuk janë “ente shtetërore” të veshura me autoritet shtetëror që të mund të dokumentojnë (nëpërmjet mbajtjes së procesverbaleve të konstatimit etj.) apo të prodhojnë akte, që të mund të shërbejnë në një moment të dytë si provë shkresore të kryerjes së një veprimi të kundërligjshëm. Pikërisht kjo është arsyeja se ankimuesi PD-AN në këtë rast është në pamundësi objektive të sigurimit të provës në mënyrën e kërkuar.

7. Është fakt që dokumentet e administruara nga subjekti ankues PD – AN, provojnë të paktën se para dhe gjatë procesit zgjedhor ka pasur ndërhyrje të diskutueshme nga pikëpamja e ligjshmërisë së tyre, të materializuara nëpërmjet aktivizimit të personave të papërshtatshëm apo përdorimit të burimeve publike në mënyrë të papërshtatshme në favor të ndonjë subjekti politik. Ka pasur ndërhyrje të diskutueshme të drejtuesve të lartë të administratës shtetërore të cilët nëpërmjet ushtrimit të pushtetit të tyre publik qoftë duke intimiduar votues të caktuar, qoftë duke favorizuar votues të caktuar nëpërmjet shpenzimit të fondeve publike, kanë influencuar në mënyrë jo të ligjshme në kategori të ndryshme zgjedhësish. Faktet e cituara në ankim janë fakte që tashmë janë botërisht të diskutuara nga opinioni publik, por kjo nuk është krejtësisht e mjaftueshme. Ajo që vlen të saktësohet në këtë procedurë shqyrtimi administrativ, është graviteti i influencimit, qoftë edhe vetëm nëpërmjet përdorimit të burimeve shtetërore, në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 si dhe impakti që këto ndërhyrje kanë pasur në devijimin e vullnetit të zgjedhësve në procesin e votimeve. Pikërisht kjo qëndron në themel të kërkesës së ankimuesit PD-AN drejtuar KAS për të marrë dhe hetuar informacionet apo provat shtesë. Kjo për të vlerësuar realisht nëse ndërhyrja e

papërshtatshme e administratës (dhe jo vetëm) në zgjedhje ka ndikuar në atë masë sa të ketë parregullsi të vogla apo parregullsi dhe shkelje të rënda të ligjit, të tilla që të bëjnë të pavlefshëm procesin e zgjedhjeve për disa nga qendrat e votimit pjesë e këtij qarku në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor dhe më pas të bëjnë të nevojshme përsëritjen e tyre.

8. Nenet 124 – 144 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë procedurën që ndjek Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve për shqyrtimin e një ankimi administrativ. Neni 136, pika 1, gërma “c” parashikon se palët kanë të drejtë të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre. Ndërsa, pika 3 përcakton se kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. KQZ-ja është e detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara. Neni 137 përcakton detyrimin që kanë organet e tjera të administratës publike për të vënë në dispozicion informacione, dokumente dhe çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.
9. Pikërisht fakti se argumentet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të jenë konkrete dhe të provueshme, është arsyeja që ankimuesi kërkoi ndërhyrjen e KAS në marrjen e informacioneve dhe administrimin e provave shtesë nga institucionet shtetërore të caktuara. Për sa kohë kjo kërkesë refuzohet, në mendimin e anëtarëve të pakicës, KAS është në pamundësi objektive për të bërë përcaktimin e kritereve, koncepteve bazë si dhe parimeve mbi të cilat duhet të mbështetet ai vetë për të konkluduar nëse shkeljet e pretenduara nga ankuesi cenojnë rëndë procesin zgjedhor në mënyrë të tillë që ta bëjnë të pavlerë rezultatin. Për ne anëtarët e pakicës, hetimi i pjesshëm i KAS duke refuzuar një sërë kërkesash në zbatim të nenit 137 të Kodit Zgjedhor ka sjellë si pasojë një vendimmarrje që nuk pasqyron produktin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të asaj se çka dy subjekte ankimuese pretenduan gjatë shqyrtimit administrativ.
10. Duke konkluduar se *“Shkelje që çenojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur”*, shumica e anëtarëve të KAS anashkalon krejtësisht në mënyrë të pajustificuar tërësinë e elementëve/fenomeneve (të cilat ankuesit i konsiderojnë si shkelje flagrante të ligjit) të cilat mund të kenë ose kanë ndikuar drejtpërdrejt në pengimin/largimin e zgjedhësve apo edhe në deformimin e vullnetit të tyre para apo gjatë procesit, duke i detyruar ata të votojnë në një mënyrë të caktuar. Në këtë kontekst,

anëtarët e shumicës kur marrin në analizë Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1076, datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, të ndryshuar”, arrijnë në konkluzionin se *“kjo VKM ka dalë brenda periudhës së ndalimit dhe sjell rritje pagash për kategori të caktuara punonjësish publikë, por nuk është kryer asnjë hetim institucional për të verifikuar faktin nëse këto fonde janë parashikuar në periudhën e ndalimit, apo para saj.”*.

11. E gjithë analiza që bën shumica e anëtarëve të KAS në lidhje me nenin 160 të K.Zgjedhor, dispozitë kjo që parashikon dhe rastet e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi, është një analizë krejtësisht e përciptë që nuk futet në themel të dispozitës dhe ta interpretoj atë në kuptimin qëllimor të saj. Është e thjeshtë që për çdo shkelje të Kodit Zgjedhor të arrish në konkluzionin se po ky kod parashikon edhe sanksionet për shkeljen përkatëse, por ama kërkon një hetim të gjithanshëm mbi prova dhe një interpretim qëllimor të Kodit Zgjedhor dhe të ligjit në përgjithësi (pasi neni 160 nuk kufizohet vetëm në shkelje të K.Zgjedhor) për të arritur në përfundimin nëse kemi të bëjmë me shkelje të tilla që pasjellin pavlefshmëri të zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi. Procesi zgjedhor kurrësi nuk mund të kufizohet vetëm në ditën e zgjedhjeve dhe në administrimin zgjedhor post ditës së zgjedhjeve pasi nuk mund të ketë zgjedhje pa formësim të vullnetit të zgjedhësve dhe nëse ky formësim vullneti është i vesuar nëpërmjet shkeljeve ligjore të gjithanshme (si ato që u pretenduan nga të dy subjektet ankimues në këtë shqyrtim administrativ) atëherë si mund të shmanget nga analiza një proces kaq i gjatë dhe kaq kompleks sa periudha 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve?! Ka qenë pikërisht vullneti i të gjitha partive politike në vend që e ka konsideruar shumë të rëndësishme këtë pjesë të periudhës zgjedhore e për rrjedhojë nëse kjo periudhë nuk analizohet për të bërë transparencë të procesit e për të garantuar publikun se veprimet dhe mosveprimet e partive politike (sidomos të atyre që kanë akses në administratën publike dhe asetet publike) kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, atëherë nuk mund të ketë drejtësi zgjedhore.

12. Shumica në arsyetimin e saj, i referohet edhe nenit 161 të K.Zgjedhor duke argumentuar se *“Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore. Kriteri ligjor për matjen e ndikimit*

përcaktohet nga neni 161 i Kodit dhe është gjithmonë numerik. Sipas pikës 2 të këtij neni “ndikim në ndarjen e mandateve për zgjedhjet në Kuvend (do të kemi) kur numri i zgjedhëse, që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme, është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse, mbi bazën e përllogaritjes...” sipas formulës d’Hond të nenit 162”, por për mendimin tonë është alogjike të përdorësh këtë argument për rrëzimin e një apo më shumë kërkesave ankimore, kur po kjo shumicë ka refuzuar marrjen e provave që do të bënin të mundur arritjen në një përfundim në lidhje me përmasën e ndikimit që kanë sjellë shkeljet ligjore të pretenduara nga subjektet ankimuese.

13. Po ashtu, po në lidhje me pavlefshmërinë, shumica e anëtarëve të KAS, në mënyrë krejt sporadike dhe pa një analizë të thelluar (nisur dhe nga rëndësia që ka ky institut i të drejtës zgjedhore) ka arritur në përfundimin se “Procesi mund të atakohet për pavlefshmëri kur provohet se integriteti ka rënë (rasti i kutive të parregullta), ose ka rënë në masën që ka prishur rezultatin (nenin 136, pika 1, shkronja “a”)”. Një përfundim i tillë, përveçse e kufizon së tepërmi kuptimin e nenit 160 të Kodit Zgjedhor, por i shndërron zgjedhjet në “votime”, duke e konsideruar një proces themelor për demokracinë e një vendi në një proces mekanik ku rregullat e garës kanë rëndësi sa për formalitet. Për ne anëtarët e pakicës, një përfundim i tillë nuk i shkon aspak përshtat konceptit dhe përkufizimit që duhet të kenë zgjedhjet në një vend demokratik dhe që ka përqafuar pluralizmin politik prej 30 vitesh tashmë.
14. Shumica e anëtarëve të KAS, në përpjekjen e tyre për t’i dhënë kuptimin e duhur institutit të pavlefshmërisë së zgjedhjeve, i janë referuar vendimit nr. 45, datë 12.11.2013 të Kolegjit Zgjedhor, vendim ky që për ne anëtarët e pakicës, në një mënyrë krejt të sforcuar, përdor një analogji të gabuar për të interpretuar nenin 160 të Kodit Zgjedhor. Megjithatë, edhe duke ju referuar këtij vendimi të Kolegjit Zgjedhor i cili ndër të tjera arsyeton se “Kolegji Zgjedhor, pasi shqyrtoi pretendimin e palës paditëse për përsëritjen e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Korçë, por edhe duke e vlerësuar këtë pretendim në raport me pretendimet e palës së interesuar, si dhe në raport me proporcionalitetin e masës së ndërhyrjes, arrin në përfundimin se në rastin konkret kanë ndodhur shkelje të ligjit që kanë cenuar procesin zgjedhor, por nuk provohet që këto shkelje të jenë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit të kryetarit të Bashkisë Korçë, çka nga ana tjetër të çojë në pavlefshmërinë e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar Bashkie në zonën zgjedhore Bashkia Korçë dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore” apo “Terminologjia “rëndë” dhe ndikimi “në një masë të tillë”, i përdorur në nenin 160, pika 1, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, imponon

kryerjen nga gjykata të një vlerësimi të arsyeshëm, objektiv dhe të paanshëm, mbi natyrën e shkeljes së ligjit. Kolegji Zgjedhor vlerëson se kuptimi i saktë dhe i drejtë i terminologjisë së përdorur në këtë dispozitë ligjore, duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi nga disa faktorë, që kanë të bëjnë me rëndësinë e shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje, kohëvazhdimin e këtyre pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe vetë qëndrimin subjektiv, që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer dhe pasojës së ardhur” mund të arrijmë në përfundimin se hetimi i përciptë i zhvilluar nga KAS, duke rrëzuar një sërë kërkesash për prova, e ka bërë të pamundur analizimin e shkeljeve ligjore të pretenduara nga subjektet ankimuese, masën e këtyre shkeljeve si dhe ndikimin që kanë pasur në formësimin e vullnetit të zgjedhësve apo dhe ndryshimin e këtij vullneti në procesin e numërimit të votave.

15. Në të njëjtën mënyrë anëtarët e shumicës, ndërkohë që analizojnë pretendimin e ankimuesve për përdorimin në mënyrë të kundërligjshme të të dhënave personale të zgjedhësve, konkludojnë se: *“Këto të dhëna janë dukshëm produkt i punës së “patronazhistëve”, mbështetur në “eksplorimin” e tregut politik nga strukturat partiake. Kjo metodë eksplorimi politik bën pjesë në taktikat tradicionale të partive politike, ndonëse metodat ndryshojnë nga njëra parti në tjetrën. Pjesa tjetër e të dhënave janë të dhëna personale, që janë siguruar në mënyrë të paqartë, përveç listës me emra zgjedhësish e cila është publike dhe u ofrohet partive politike në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor (pika 2 e nenit 60). Provat e paraqitura në këtë kontekst provojnë sensibilitetin ndaj ngjarjes, por jo ndikimin e saj tek votuesit. Subjekti ankues nuk solli prova se publikimi mund të kishte intimiduar zgjedhësit dhe t’i kishte mbajtur ata larg nga procesi i votimit”.*

Për ne anëtarët në pakicë, vlerësimi i përciptë i këtij fenomeni, nuk shpjegon se si është e mundur ekzistenca në këto lista e elementëve të të dhënave personale (nr. ID dhe nr. telefoni), të cilat ruhen dhe administrohen ekskluzivisht nga institucione të caktuara shtetërore apo ndërthurja e këtyre të dhënave personale me të dhëna si vendi i punës, etj. shoqëruar dhe me komente të natyrave penale se si mundëj që një votues i “pabindur” të shndërrohej në një votues të “bindur” Në të njëjtën mënyrë, për mendimin tonë, nuk mund të shpjegohet as efekti që mund të ketë dhënë dalja e publike e Kryeministrit në një takim elektoral pak ditë para ditës së zgjedhjeve duke iu drejtuar pjesëmarrësve por edhe publikut që e ndiqte nëpërmjet medias me mesazhe falënderimi të përsëritura për patronazhistët.

Të gjitha këto elementë të marrë së bashku krijojnë dukshëm një frymë pasigurie tek qytetarët lidhur me garantimin e fshehtësisë së mendimit të tyre politik, klimë e cila shkon tërësisht në favor të partisë në pushtet.

Në përfundimet paraprake të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE-ODIHR gjenden përfundime të tilla si më poshtë vijon:

“Partia qeverisëse mori avantazhe të konsiderueshme nga të qenit në pushtet, duke përfshirë përmes kontrollit të administratës lokale dhe nga shpërdorimi i burimeve të administratës publike. Kjo u amplifikua përmes mbulimit pozitiv të institucioneve shtetërore në media”;

“Praktikat gjerësisht të përhapura të shitblerjes së votave vazhduan të përbënin problem. Rrjedhja e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabil”;

“Pavarësisht një kuadri ligjor solid që ndalon shpërdorimin e burimeve administrative dhe minimizon avantazhin e partisë në pushtet, ministrat vazhduan të bënin fushatë gjatë angazhimeve zyrtare. Publiciteti që erdhi si rrjedhojë e kësaj i dha partisë qeverisëse një avantazh të konsiderueshëm. Ofrimi i stimujve dhe presioni i pretenduar ndaj nëpunësve civilë përbënë shqetësim”;

“Kodi Zgjedhor kërkon që angazhimet zyrtare brenda katër muajsh para ditës së zgjedhjeve të raportohen të paktën pesë ditë para në KQZ. Ministrat vazhduan me angazhimet e tyre zyrtare gjatë gjithë fushatës. Ata u shfaqën rregullisht në “vizita inspektimesh” të objekteve kyçe, si në qendrat e vaksinimit, me maska në fytyrë ose me bluza që lexonin “Nr. 12” (numri i PS-së në fletën e votimit), gjë që çoi në publicitet të konsiderueshëm dhe që përbëri aktivitet për qëllime fushate. Edhe Kryeministri inauguroi disa projekte madhore infrastrukturore gjatë fushatës zgjedhore. Këto lloj aktivitetesh i dhanë një avantazh të konsiderueshëm PS-së, gjë që ishte përforcuar tashmë edhe më shumë nga dominimi i PS-së në administratën lokale. Përveç kësaj, punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore, saktësisht në kohën para moratoriumit ndaj autorizimit të punësimeve të reja në administratën publike.

Gjatë fushatës, përmes një rrjedhjeje informacioni, në domeinin publik doli një databazë me informacione personale dhe detaje kontakti për afërsisht 900,000 qytetarë shqiptarë, që përmbante edhe preferencat e tyre potenciale të votimit. Partitë opozitare, Presidenti dhe shumë të tjerë në media bënë thirrje për hetim nga SPAK-u të këtij shpërdorimi të pretenduar të të dhënave personale të qytetarëve. Disa bashkëbisedues të MNVZ-së nga partitë kryesore politike besonin se një incident i tillë mund të konsiderohej nga elektorati si shpërdorim i të dhënave personale për interesa të partive”.

Janë të gjitha këto gjetje që duhet të merreshin parasysh nga KAS dhe të hetoheshin në mënyrë të thelluar pasi kjo do të ishte e vetmja mënyrë për të arritur në një vendimmarrje të drejtë, në lidhje me pretendimet e palëve ankimuese.

16. Lidhur me numrin e lartë të fletëve të votimit të pavlefshme, anëtarët e shumicës argumentojnë se “Subjekti ankues nuk paraqiti asnjë fakt që të provonte lidhjen shkakësore midis vendimit të Kolegjit Zgjedhor për përmbajtjen e fletës së votimit dhe numrit të lartë të fletëve të pavlefshme.ka një grup shkaqesh, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë analizës faktike rreth kësaj çështjeje si p.sh. fakti se në këto zgjedhje u votua me dy vota dhe probabiliteti i gabimit dyfishohej, fakti se fushata edukuese nuk pati efektin e dëshiruar ose nuk e davariti dot konfuzionin, fakti se kandidatët nuk harmonizuan dot mënyrën e re të votimit me taktikat elektorale, apo fakti se pavlefshmëria mund të ishte mënyrë votimi me dashje nuk mund të eliminohen vetëm për shkak se nuk përputhen me linjën e arsytimit të ankuesit.”.

Në opinionin e anëtarëve të pakicës, numri i madh i fletëve të votimit të pavlefshme dëshmon se hartimi i fletës së votimit me vonesë pikërisht për shkak të ankimimeve që bëri subjekti PS në KAS dhe më pas në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e saj, solli pamundësinë objektive të administratës zgjedhore të konceptonte dhe të fillonte në një kohë të arsyeshme një fushatë informuese për publikun lidhur me mënyrën e votimit me fletën e re të ndryshuar (me numra) nga ajo e miratuar paraprakisht (me emrat e kandidatëve).

Në këtë linjë arsytimi, edhe misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it ka identifikuar si shkak të mundshëm të numrit të madh të fletëve të votimit të pavlefshme, vonesën në nisjen e fushatës informuese-edukuese.

17. Potencialisht elementët/fenomenet e mësipërme të pretenduar si parregullsi nga ankimuesit, të analizuar veçmas si raste të izoluara, mund të mos përbëjnë në dukje shkak ligjor për të pasjellë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë të caktuar, por nëse e vlerësojmë këtë dukuri në këndvështrim të harmonizimit të të gjithë elementëve të kundërligjshëm të koordinuar paraprakisht, atëherë potencialisht ekziston një dyshim i arsyeshëm që graviteti i veprimtarisë së kundërligjshme të mund të ketë ndikuar në një mënyrë dhe masë të tillë në vullnetin e zgjedhësve sa që të mund të sjellë si pasojë pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

Për sa kohë KAS nuk është në gjendje të verifikojë apo të konstatojë përmasën e këtyre “parregullsive procedurale”, atëherë afërmendsh që është në pamundësi të konkludojë drejtë nëse këto shkelje formojnë ose jo parregullsi ligjore të tilla që të mund të sjellin pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

18. Pavarësisht efektshmërisë të filtrave apo “masave mbrojtëse” të marra për mbarëvajtjen e procesit në ditën e zgjedhjeve të tilla si: procedura e rreptë e kontrollit të identitetit të votuesit, përdorimi i bojës matrikulluese, lënia e gjurmës së gishtit në pajisjen PEI, kontrolli i të dhënave të grumbulluara nga pajisjet PEI për të gjithë vendin dhe së fundi, mbikëqyrja reciproke e anëtarëve të komisioneve dhe monitorimi i këtyre të fundit nga vëzhguesit e subjekteve, ende mbetet pa përgjigje pyetja: *A janë efikase këto masa në rastet e ushtrimit të ndikimit të kundërligjshëm tek votuesit kohë përpara ditës së zgjedhjeve?* Si edhe pyetja: *A do të kishte kuptim kontrolli dhe mbikëqyrja e rreptë e procesit të votimit në rastin kur p.sh. javë apo muaj përpara ditës së zgjedhjeve, për shkak të ndërhyrjeve në kundërshtim me ligjin, votuesit janë intimiduar ose edhe janë joshur në atë masë që ata të pengohen të votojnë në atë mënyrë që do të votonin nëse nuk do të ekzistonin këto ndërhyrje?!* Apo pyetja tjetër: *Sa vlerë ka vullneti i votuesit nëse veprimet aktive të një partie politike, të aktivistëve të saj apo të administratës publike në nivel qendror apo vendor tjetërsojnë vullnetin e votuesve dhe a do t'i plotësonte elementët e nenit 160 të Kodit Zgjedhor për pavlefshmërinë cënimi i vullnetit të votuesit përpara se ai t'i drejtohej qendrës së votimit?!*

19. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se për sa kohë hetimi administrativ që kufizon marrjen e provave ku palët bazojnë pretendimet e tyre, nuk u jep një përgjigje shteruese pyetjeve të përmendura më lart, vendimi i marrë me shumicën e votave të anëtarëve të KAS për rrëzimin e kërkesave ankimore nr. 35 të subjektit zgjedhor partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe nr. 42 të subjektit zgjedhor koalicioni Partia Demokratike e Shqipërisë – Aleanca për Ndryshim është një vendim i pabazuar në prova e në ligj.

Elvis ÇEFA - Kryesues

Ledio BRAHO - Anëtar